



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

---

**SKEMA E VLERËSIMIT**

**Olimpiada e gjuhës shqipe dhe e letërsisë**

**Faza II**

**Viti shkollor 2015-2016**

**Klasa 10**

**2 prill 2016**

*Kjo skemë vlerësimi është orientuese.*

*Përgjigjet e nxënësve do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e dhëna më poshtë. Secili kriter ka një total pikësh. Nxënësi duhet të shfaqë disa kompetenca për secilin kriter, të cilat qartësohen në tabelën përkatëse. Kjo tabelë shpreh në mënyrë të detajuar se çfarë duhet të përmbushë nxënësi për të marrë pikë të plota apo ndërmjetëse.*

1. Ne e kuptojmë rëndësinë e kohës vetëm kur na ka mbetur shumë pak prej saj. A jeni dakord apo jo me këtë pohim? Pse? Argumentoni mendimin me shembuj nga përvoja juaj ose e njerëzve që njihni. . **20 pikë**

## **Rubrikat e vlerësimit**

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** hapësira në të cilën përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe krijon një histori (ngjarje), ku vendin kryesor e zë përfytyrimi dhe imagjinata.  
Zhvillimi i ideve, duke përdorur detaje specifike, imazhe dhe figura mbresëlënëse të përzgjedhura me shumë kujdes. **5 pikë**
- II. Organizimi:** hapësira në të cilën përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **5 pikë**
- III. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **5 pikë**
- IV. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **5 pikë**

2. Si mendoni, pse disa njerëz tërhiqen kaq shumë nga sporte apo veprimtari të tjera të rrezikshme? Përdorni shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen tuaj.

**15 pikë**

### **Rubrikat e vlerësimit**

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon. **3 pikë**
- II. Zhvillimi:** përgjigjja e dhënë përmban detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **3 pikë**

3. Nuk është gjithmonë e lehtë të marrësh anën e mirë, madje ndonjëherë është e rrezikshme.

Përshkruani një moment në jetën tuaj, kur ju e vendosët veten tuaj në rrezik (emocional, psikologjik apo fizik) për të bërë atë që ju mendonit se ishte e drejtë.

15 pikë

## Rubrikat e vlerësimi

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon. **3 pikë**
- II. Zhvillimi:** përgjigja e dhënë përmban detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **3 pikë**